



## “Ligjërata njëditore e BE-së” 2009

### Fëmijët e Kosovës diskutojnë me diplomatë të BE-së të ardhmen evropiane të Kosovës

14 maj – 13 qershor 2009

Nxënësit nga mbarë Kosova do të mund të diskutojnë për mundësitë dhe sfidat që ka Kosova në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian gjatë projektit të quajtur “Ligjërata njëditore e BE-së”. Diplomatë nga BE-ja së bashku me përfaqësues të pranive të BE-së në Kosovë do të vizitojnë shkollat e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë nëpër Kosovë deri në mesin e qershorit.

Përfaqësues nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së do të shpjegojnë se çfarë domethënie ka BE-ja për secilin individualisht dhe do të sjellin shembuj konkretë se si të gjitha shtetet anëtare janë të përkushtuara ndaj perspektivës evropiane të Kosovës si pjesë e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

#### **E enjte, 14 maj – ora 9.30, Gjymnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë:**

Ligjërata e parë e “Ligjërata njëditore e BE-së” me  
Zëvendës Ministrin e Arsimit Agim Hyseni dhe  
Alison Weston, Shefe e Kabinetit të EUSR-së

Projekti është nismë e zyrës së EUSR-së (*Përfaqësuesit Special të BE-së*), Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe e Presidencës Çeke në Kosovë.

#### **Pieter Feith, Përfaqësues Special i BE-së:**

*“Të rinjtë janë ata të cilët janë të thirrur për paramendimin dhe krijimin e së ardhmes së tyre. Ata janë trashëgimtarët e së ardhmes dhe ne duhet të marrim përgjegjësitë tona për t’i nxitur ata që mu tani të bëhen partnerë të së ardhmes evropiane. Prandaj, jam i lumtur që gjatë javëve në vazhdim, ambasadorët e BE-së dhe përfaqësuesit e misionëve të BE-së do t’i vizitojnë shkollat anekënd Kosovës për ta dëgjuar vizionin e tyre për të ardhmen evropiane të Kosovës dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me BE-në”*

#### **Enver Hoxhaj, Ministër i Arsimit:**

*“Qeveria e Kosovës është shumë e përkushtuar të krijojë një të ardhme më të mirë për brezat e rinj. Njëri nga objektivat kryesore është që arsimit të ndërlihet me nevojat e ekonomisë dhe*



*krijimi i një shoqërie bazuar në zhvillim dhe njohuri konkurruese duke krijuar vende të reja pune. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë po ndërton një sistem edukimi me orientim evropian me anë të përmbushjes së praktikave dhe standardeve evropiane, ku arsimi është ekonomi dhe ekonomia është Evropë.”*

**Janina Hřebíčková, Ambasadorja çeke në emër të Presidencës Çeke në Kosovë:**

*“Brezat e prindërve dhe gjyshërve tanë kanë qenë të privuar nga e drejta e një arsimi të lirë, tolerant dhe të paanshëm, gjë që përbën një pjesë të domosdoshme të lirive dhe të drejtave të njeriut. Tani kur unë nuk përfaqësoj vetëm shtetin tim prej nga vij, por tërë familjen evropiane në emër të Presidencës Çeke të BE-së në Kosovë, kam nderin t’i drejtohem një brezi të ri të nxënësve të Kosovës të cilët do të edukohen në një arsim dhe të ardhme që bazohet në këto të drejta të domosdoshme të njeriut.”*

Vërejtje:

- Vizitat “Ligjërata njëditore e BE-së” kanë për cak nxënësit e shkollave dhe nuk janë të hapura për publikun. Publiku mund t’i ndjek zhvillimet rreth këtij projekti përmes faqes së internetit të [Ligjëratës njëditore të BE-së](#) gjatë ditëve në vijim.
- Njoftimet për media: do të dërgohen para vizitës së “Ligjërata njëditore e BE-së” kur prania e mediave është e mirëseardhur. Për informata, luteni t’i drejtoheni Betim Nimanit, asistentit për shtyp: Betim Nimani: telefoni fiks 038 2044 336; telefoni celular: 044 57 071

